



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 5, datë 25.06.2024

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 25.06.2024

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako, si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve.

Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kyetare ! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës.

Në këtë mbledhje, do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë dhe një projektvendim i propozuar nga Komisioni i Mandateve.

Ftoj sekretaren të bëj prezencën.

Dorina Milja: Përshëndetje.... Fillojmë.

Ardian Muka ... Prezentderi tek.... Florian Tahiri...Mungon

33 Këshilltarë në sallë .

V.O... Hyn me vonesë gjatë mbledhjes këshilltarët Edlira Shemsi, Kontjana Kuçi, Florian Tahiri, Ermal Braholli, prezent ishte dhe kandidatja për anëtare e KB, Periana Kotri. Ikin gjatë mbledhjes Sami Osmani dhe Kontjana Kuçi). Gjithsej gjatë mbledhjes 38 këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi: Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Sot në rend dite kemi 16 pika. Po kaloj në leximin e tyre.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit Komisioni Mandateve	PËR MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARES SË KËSHILLIT BASHKIAK ZJ. PERIANA PIRO KOTRI
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN MAJ 2024
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 2, KATUND I RI, SUKTH, MANËZ DHE ISHËM BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 5'829'106 LEKË, PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NJËMBËDHJETË PARAPRAKE TË 31 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 65, DATË 17.03.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TETË PARAPRAKE TË 14 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA”
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 189, DATË 22.12.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA “VRESHTAVE” PALLATI NR.8, I

	DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 61, DATË 28.02.2023 PËRSA I PËRKET ZNJ. SABRIJE KOTOBELLI, Z. MURAT KOTOBELLI, ZNJ. VITRIJE KOTOBELLI, Z. GEZIM KOTOBELLI, Z. KRESHNIK KOTOBELLI, Z. XHEVAHIR KOTOBELLI, ZNJ. NAILE KOTOBELLI DHE ZNJ. ALESSIA KOTOBELLI SI DHE PËRSA I PËRKET Z. SYBI NANUSHI, ZNJ. AFËRDITA NANUSHI, Z. ILIRJAN NANUSHI DHE Z. EDVALDO NANUSHI
Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË RINDËRTIMIT PËR VITIN 2024 AKORDUAR NË FORMËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA PALLAT DHE NJËSI INDIVIDUALE, DHE RINDËRTIMIN E BANESAVE INDIVIDUALE, DURRËS
Pika 10. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 242611.2 (DYQIND E DYZETË E DY MIJË E GJASHTËQIND E NJËMBËDHJETË, PIKË DY) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE, VADARDHË”, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH
Pika 11. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH, TË PASURIVE ME NR. 55/12, 55/96; 55/15 DHE 55/17, E LLOJIT TRUALL, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 150.5 M ² , ME VENDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 3690, VADARDHË
Pika 12. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR PËRCAKTIMIN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË DHE SHESHE NË TERRITORIN E BASHKISË DURRËS
Pika 13. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PASQYRËS NR.4, “PLANI I SHPENZIMEVE KAPITALE NGA BURIMET E VETA PËR VITET 2024-2026”, MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 195, DATË 22.12.2023, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024 - 2026 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2024”
Pika 14. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN QERSHOR 2024

<p>Pika 15. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.3, DATË 6.02.2024 “PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA KU DO TË USHTROHET VEPRIMTARIA SI STACION PLAZHI, PLAZHET PUBLIKE PËR VITIN 2024 SI DHE PLOTËSIMIN E SAJ ME ELEMENTËT E NEVOJSHËM LIDHUR ME STANDARTET E KËRKUARA NGA AKTET LIGJORE NË FUQI”, I NDRYSHUAR</p>
<p>Pika 16. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT KRYETARIT TË BASHKISË DURRËS, ZNJ.EMIRIANA SAKO, PËR TË PËRFAQËSUAR BASHKINË DURRËS NË SEANCËN PLENARE PUBLIKE, QË DO TË ZHVILLOHET NË GJYKATËN KUSHTETUESE, LIDHUR ME PROJEKTIN E INVESTIMIT STRATEGJIK “MARINA & JAHTET E DURRËSIT”</p>

Këto ishin pikat e rendit të ditës.

Atëhere, kemi ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?

Po z. Myshketa

Jonuz Myshketa: Në dëgjesën publike që u bë në sallën e Këshillit Bashkiak ku kam kërkuar në bazë të ligjit 139/2015 “Për vetëqeversjen vendore”, të ndryshuar, të ligjit 146/2014 “Për konsultimin publik”, në lidhje me pikën 12, që është për përcaktimin e tarifave të parkimit në zonën A dhe B që është projektvendimi për tu bërë me pagesë, kërkoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës dhe të bëhet një dëgjesë publike më e thelluar, pasi dëgjesa ku ishim prezent ishte një dëgjesë e pamjaftueshme. Kjo u vu re nga komunikimi që kemi pasur me qytetarë dhe grupe interesi, të cilët nuk kanë qënë të informuar për këtë dhe kërkojnë një sqarim shterues dhe të marrim një fitbek (fit back) më të thelluar në lidhje me ç’ka janë nevojat e grupeve të interesit dhe qytetarëve të Durrësit.

Nisma në vetvete, mund të jetë një nisëm që mund të shërbej, por këtu unë nuk shoh që ka një alternativ paraprake në lidhje me, pra shkohet menjëherë në tarifimin me pagesë të qytetarëve pa gjetur ndonjë alternative. E thelloj këtë kërkesë, duke uruar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin me gjithë kolegët në sallë, pasi nuk është një kërkesë politike, por është një kërkesë për qytetarët. Dhe gjykoj që dhe në materialet e paraqitur sot dhe për pikën 12, ditët dhe oraret e qëndrimit në dëgjesën publike ishte paraqitur që periudha nga 1 qershor deri ne 30 shtator për orarin e 8 -20 të darkës, të ishte periudha nga e hëna në të premte, në materialin e sotëm paraqitet që pagesa do jetë nga e hëna deri në të dielë për të gjithë sezonin turistik. Janë gjëra, të cilat duhen konsultuar dhe pastaj të kalohet në një projektvendim më detajues, marrim të gjithë informacionin dhe gjithë fit back-un e qytetarëve. Kjo ishte kërkesa ime për pikën 12 të rendit të ditës. Ju faleminderit.

Ani Dyrmishi : Po, Flutura.

Flutura Kasa: Jam dakord me kërkesën e Jonit, por kanë pas mundësi të mjaftueshme, se atë ditë që është bërë dëgjesa, opozita ka për detyrë shumë më tepër se sa maxhoranca për të lajmëruar njerëzit në momentin që ato e marrin njoftimin.

Nuk u bo kjo ! S'është aspak faji i bashkisë. Tjetra nuk erdhi i pranishëm në mbledhjen e kryesisë ku kishte mundësi për ta rrëzuar që kjo pikë të mos hynte te rendi ditës, kështu që mua më duket sikur nuk qëndron shumë kjo ankesë që bëri Joni. Kaq kisha.

Jonuz Myshketa: Unë do i përgjigjem replikës së bërë.

Përsa i përket që nuk kam qënë prezent ishte për arsye personale duke mos qënë në Shqipëri atë periudhë, e kam shprehur dhe njëherë, nuk e di nëse e keni lexuar duke shprehur pamundësinë e ardhjes sime, por në mbledhjen e kryesisë kemi qënë të përfaqësuar denjësisht dhe nga kolegët tanë dhe kolegja Devolli ka parashtruar këtë kërkesë si një kërkesë jo politike, por si një kërkesë dhe nevojë qytetare.

Ju thonë që, opozita duhet t'i njoftoj. Patjetër që opozita do bëjë punën e vet, por bashkia si institucion, mendoj që nuk është as i opozitës, as i maxhorancës, por duhet të jetë në shërbim të qytetarëve. Duhet të merren të gjitha masat për njoftimin publik, në mediat e shkruara, në mediat vizive, qoftë dhe një pankartë përpara bashkisë ose para sheshit ku ndodhet bashkia, sepse është në interes të publikut të sqarohet, pasi rëndon ose e vështirëson pjesën e parkimeve, prandaj i qëndroj kësaj kërkesë. Faleminderit.

Flutura Kasa: Ke dhe të drejtën e zëvendësimit Joni.

Ani Dyrmishi : Po z, Burgija.

Dritan Burgija : Dakord e mbështes nismën për me e heq nga rendi i ditës pikën. Është një pikë që ka ndjesi qytetare, është pikë që ka të bëjë direkt me xhepat e qytetarëve durrsak, kështu që nëse bim dakord me kolegët ta heqim sot dhe ta shqyrtojmë domethënë me vonë por me qetësi këtë punë se mund të ketë variante shumë të tjera nga ky, që na është paraqitur dhe bëjmë më të mirën e mundshme. Dhe e kuptoj dhe shqetësimin e qytetarëve që mund të kenë ardh te juve për parkimet në Durrës. Në këndvështrimin tim dhe kjo nuk ka për ta zgjidh dot problematikën. Por, një gjë tjetër që doja të shtoja, përpara se të fillojmë shqyrtimin e pikave të rendit të ditës është një kërkesë nga Partia Demokratike për ndryshimin e emërtimeve të grupeve.

Ani Dyrmishi: Emërtimet e çfarë.... Çfarë?

Dritan Burgija: Emërtimet e grupeve.

Ani Dyrmishi: Keni bërë kërkesë me shkrim?

Dritan Burgija : Po e bëjmë këtu. Thashë kërkesë në emër të Partisë Demokratike. Nëse është e nevojshme e bëjmë edhe me shkrim.

Ani Dyrmishi: Procedura është e tillë...

Dritan Burgija: Kjo është një temë e gjatë, që unë mund të flas shumë gjatë, por nuk është vendi këtu, pas një kalvari 20 vjeçar.

Ani Dyrmishi : Duhet ta bëni kërkesë më shkrim, por këtu jemi për rendin e ditës.

Dritan Burgija: Dakord, jo jo dakord, nuk dua ta kthej në debat, por unë, thjesht regjistrojeni paraprakisht.

Ani Dyrmishi: Nëse Ju keni dorëzuar kërkesë, patjetër që do merret në shqyrtim.

Sami Osmani: Do merret vendimi gjykatësit. Prit duro dhe pak ditë.

Ani Dyrmishi: Vazhdojmë...

Po Znj. Musaraj.

Joniada Musaraj: Faleminderit Kryetar.

Në lidhje me rendin e ditës me pikën që pretendohet të hiqet sot, unë kam dy argumenta së pari procedura tek ne bazohet tek rregullorja dhe rregullorja parashikon komisionet, paraprakisht është e gjithë mundësia që të jepet në komision për të shqyrtuar çështjet, pikat, përpara se të hidhet në këshillin bashkiak, që do të thotë në dijeninë time ka patur diskutime është e vërtete për parkimin në komisione, por nuk është kërkuar heqja nga rendi i ditës. E para kjo dhe e dyta kam vënë re që ju gjithmonë vini dhe propozoni heqjen në rendin e ditës, ndryshimin e pikave të rendit të ditës por kurrë nuk vini dhe kundërshtoni me argumenta që pse kjo alternative që propozohet sot, nuk është ajo e duhura. Tani le të dallojmë ne, nga ata që jemi duke pirë kafe tek lokali përballë, se prandaj jemi zgjedhur këtu, që kur japim mendimet tona, vimë me argumenta tona, s'është e saktë kjo pikërisht për këtë arsye ose mendoj të propozohet kështu pikërisht për këtë arsye. Kështu që, unë mendoj që diskutimet bëhen nëpër komisione dhe pastaj këtu. Faleminderit.

Rolant Xhelilaj: Kryetar.

Ani Dyrmishi : Z. Xhelili.

Rolant Xhelilaj: Me leje, kam dhe unë një koment për të bërë.

Ani Dyrmishi: Në lidhje me rendin e ditës?

Roland Xhelili: Po pra.

Në lidhje me rendin e ditës, nga zoti Myshketa u mbajt një qëndrim, pasi ka qëndrime të grupeve, Tani mbajti qëndrimin e vet. Ne të Partisë Socialiste jemi të mendimit që është një propozim normal, që bëhet për një paraqitje të kujdesit për situatën që krijon kjo pikë. Nuk ka lidhje fare

as me pikën, as rendin e ditës, as duhet bërë sot apo s' duhet bërë sot dhe qëndrimi jonë është që të kalohet siç është.

Ani Dyrmishi: Koment tjetër ka?.

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës, në formën e paraqitur nga Sekretaria?

23 pro.

Kundra?.....12 kundra

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 23 vota pro dhe 12 kundra, miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën nr. 1**. I japim fjalën Komisionit të Mandateve znj. Ana Dhamo, të paraqesë raportin.

Ana Dhamo: Përshëndetje! Faleminderit zoti kryetar!

Komisioni i Mandateve u mbledh për shqyrtimin e relacionit të projektvendimit të paraqitur dhe në unanimitet vendosi të ia kalojë këshillit bashkiak që të vendosi miratimin e mandatit të anëtares së këshillit bashkiak Durrës, kandidate nga lista shumemërore e Partisë Socialiste znj. Periana Piro Kotri. Ju faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Atëherë kush është pro?

Kundra? ...Nuk ka.

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëhere, me 35 vota pro miratohet dhe pika 1 e rendit të ditës.

Zj. Periana Kotri ju ftoj të ngriheni në këmbë, unë do ju lexoj formulën e betimit, dhe ju në fund do të thoni : **Betohem**

“Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Durrës dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Periana Kotri: Betohem.

Ani Dyrmishi: Urime.

Periana Kotri: Faleminderit .

Ani Dyrmishi: Atëherë kalojmë **në pikën 2**. I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit znj Shemsi.

Edlira Shemsi : Përshëndetje kryetar!

Komisioni i Barazisë Gjinore Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit pasi shqyrtoi listën për individët që do marrin ndihmë ekonomike për muajin Maj me fondin e kushtëzuar 6 % dhe me fondin e të ardhurave të bashkisë, miratoi atë dhe ia kaloi Këshillit për miratim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 2, ka ?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës? ...

Kundra? ... Nuk ka

Abstenim?....Nuk ka.

Dorina Milja : Iku Samiu, voton Periana.

Ani Dyrmishi : Atëherë me 35 vota pro miratohet pika 2 e rendit të ditës..

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 3**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Edlira Devolli.

Edlira Devolli: Faleminderit kryetar.

Komisioni i Rregullores, Çështjeve Judrike, pasi shqyrtoi çështjen vendosi ta kalojë në seancë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë Komisioni shqyrtoi pikën 3, e votoi në unanimitet dhe propozon ta kalojë në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 3, ka nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim?.... Nuk ka.

Atëhere, me 35 vota pro, miratohet pika 3 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 4**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave z.Rolant Xhelilaj .

Rolant Xhelilaj: Në komisionin tonë pika 4 kaloi me vota unanime, ia kalojmë këshillit për votim.

Ani Dyrmyshi: Faleminderit!

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë z. Ervis Bekteshi.

Ervis Bekteshi: Përshendetje!

Komisioni i Mbrojtjes Civile dhe Sigurisë Publike dhe Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë u mblodh, e shqyrtoi dhe e propozon për miratim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 4, kemi nga ana e këshilltarëve?

Po, z. Muka.

Adrian Muka: Për këtë pikë dhe herës së kaluar kur patëm një fond për objektet e dëmtuara nga zjarri i shtrova një pyetje kryetares kur thashë : Klasifikimit që i bëhet personave i merret parasysh nëse ka dy shtëpi kur njëra i është djegur, jepet ndihma? Dhe kryetarja tha që po.

Kemi një rast evident e ngrita dhe herës së kaluar ku një qytetar durrsak e ka ngritur këtë problem, dhe edhe në këtë listë ai nuk është përfshirë. E kam bërë prezent edhe njërit prej nënkryetarëve këtë problem dhe besoj që të jetë prezent në listën tjetër. Por gjithsesi një përgjigje e doja, pra do veprohet si me tërmetin kur dikush ka një shtëpi dhe një e ka blerë për djalin dhe ka pësuar zjarr. A e përfitojnë ato, për aq sa përfitohet domethënë? Sepse për pjesën e tërmetit jemi të gjithë të qartë që kush kishte dy apo tre shpia mori vetëm një, s'është e moralshme. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente të tjera përsa i përket pikës 4, ka?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 35 vota pro, miratohet pika 4 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 5**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores , Çështjeve Juridike zonja Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mblodh shqyrtoi çështjen vendosi ta kalojë në seancë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë Komisioni ynë pikën 5, e miratoi dhe e propozon sot për votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 5, kemi?

Komente nuk ka.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëherë, me 35 vota pro, miratohet pika 5 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 6**. Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike zonja Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mbledh shqyrtoi çështjen vendosi ta kalojë në seancë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë Komisioni ynë dhe pikën 6, propozon për ta votuar. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 6, kemi ?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëherë, me 35 vota pro, miratohet pika 6 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 7**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores , Çështjeve Juridike zonja Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mbledh shqyrtoi çështjen vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë Komisioni ynë pikën 7, propozon për ta kaluar për votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 7, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëherë, me 35 vota pro, miratohet pika 7 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 8**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores , Çështjeve Juridike zonja Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mblodh, shqyrtoi çështjen, vendosi ta kalojë në seancë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë për pikën 8, ram dakord ta kalojmë sot për votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 8, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 35 vota pro, miratohet.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 9**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave z. Xhelilaj

Rolant Xhelilaj: Në komisionin tonë pika 9, kaloi me vota e mazhorancës për votim në këshill, opozita abstenoj.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës z. Muka.

Adrian Muka: Në këtë version kaloi gjithçka, në rregull.

Ani Dyrmishi: Faleminderit z. Muka.

Koment përse i përket pikës 9, kemi ?.

Nuk ka. Atëhere kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra ka?....

Abstenim?....

Jonuz Myshketa : Për pikën 9 të buxhetit ne kemi votuar pro. Ka qenë një pikë tjetër që kemi abstenuar.

Ani Dyrmishi: Është lapsus.

Jonuz Myshketa : Jo, sa për sqarim.

Ani Dyrmishi: Atëherë për pikën 9, pro?

Se e ke të bardhë atë. (..i flet B.Reçit..)

Blerina Reçi : E di, pra.

Ani Dyrmishi: 34

Dorina Milja : 34 pro, 1 abstenim.

Ani Dyrmishi: Atëhere, me 34 pro, 1 abstenim, miratohet pika 9.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 10**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonja Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mbledh shqyrtoi çështjen vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Hekuran Markola

Hekuran Markola : Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Pronave Publike në unanimitet e kalon për votim në këshill bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit

Komente për pikën 10, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 35 vota pro, miratohet pika 10.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 11**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonja Devolli.

Edlira Devolli: Faleminderit.

Komisioni u mbledh shqyrtoi çështjen vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Hekuran Markola

Hekuran Markola : Edhe pika 11, kalon në unanimitet për votim në këshill bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit

Komente përsa i përket pikës 11, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

34 pro.

Samet ti votove pro?

Atëhere, me 35 vota pro, miratohet pika 11 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 12**. I japim fjalën

Florian Tahiri : Marojmë të gjitha pikat dhe e lëmë të fundit atë?

Ani Dyrmishi : Urdhëro?

Florian Tahiri : Pikën 12, nëqoftëse është mundësia ta lëmë të fundit.

Dorina Milja : Për parkingun flet ?

Florian Tahiri : Po, ta lëmë të fundit atë, se besoj do të ketë debate.

Dorina Milja : U miratua rendi ditës.

Ani Dyrmishi : Duhej bërë kërkesa në fillim të rendit të ditës.

Ju lutem.

.....(Ju lutem qetësi, shumë zhurmë...)

Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike znj.Devolli.

Edlira Devolli: Po kryetar.

Komisioni shqyrtoi çështjen dhe me shumicë votash e kaloi në seancë.

Ani Dyrmishi: Ju faleminderit.

I kalojmë fjalën Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor rrugor z.Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Atëherë pika 12 në Komisionin e Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, në unanimitet miratohet dhe i kalon për votim këshillit bashkiak, por me një kusht që u vendos në komision, u tha në komision që të rishikohet nga bashkia tarifa e zonës A dhe zonës B për abonetë po e quaj, që është 10 mijë lekë në vit të jetë në propocional me çmimin për tarifën që është 100 lekë në orë zona A dhe 40 lekë në orë zona B, ky ishte i vetmi kusht, në unimaniet kaloj për votim, vetëm njëri nga përfaqësuesit e opozitës ishte abstenim.

Ani Dyrmishi: Ju faleminderit

Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik znj.Reçi.

Blerina Reçi : Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik u mbledh dje dhe shqyrtoi çështjen. Më lejoni t'ju shpjegoj dinamikat se si arriti të përcjell në këshill bashkiak këtë projektvendim. Edhe në dëgjesa u tha për alternativa të munguara të transportit publik. Në mazhoranc marrim

vendimin si komision ta përcjellim në këshill bashkiak me shumicë votash, por me ndryshime në përmbajtje. Këto ndryshime në përmbajtje me shumicë votash në Komisionin e Politikave të Zhvillimit Ekonomik janë ndryshimi i tarifave të parkimeve Zona A -60 lekë, Zona B- 40 lekë dhe tarifa vjetore 5.000 lekë.

Unë shpresoj që të kihet në vëmendje jo vetëm këto ndryshime që ne propozojmë por edhe pse e dikujtojmë akoma më mirë, sepse është një interes shumë i rëndësishëm, shumë i madh për të gjithë ne. Të kihen në vëmendje ndryshimet që ne propozojmë ku ishim shumica 4 anëtarë ishin pro dhe 2 ishin të qëndrojnë siç janë. Pra propozojmë ndryshimin e tarifave. Ju faleminderit, shumë.

Ani Dyrmishi: Atëherë përse i përket pikës 12, komente ka ?

Po, zoti Muka.

Ardian Muka: Edhe në pjesën e dëgjësës që u bë me komunitetin ne e ngritëm si problem, por edhe në komision diskutova, propozimi vjen me dëshirën e mirë dhe me llogjikën që duke bërë parkimet me pagesë, pra parkimi edhe në rrugë, por edhe ne sheshe të ndryshme apo rrugë kryesore, të krijojmë mundësinë e ndonjë viabiliteti më të mirë për qytetin tonë, ku zgjidhim dhe problemin e parkimit që është një nga problemet kryesore që Durrësi ka.

Në komentet e mia në të gjitha këto debatet që kam pasur është që jemi vonë, por nuk jemi gati. Çfarë dua të them? Nuk besoj që duam ta ngremë thjesht në principin që është shtrenjtë apo është lirë 1000 lekë më shumë apo 2000 lekë më pak, problemi është që me këtë çfarë neve po kërkojmë a arrijmë ta realizojmë atë ca është qëllimi? Për mendimin tim thashë jemi vonë, por nuk jemi akoma gati.

Nga diskutimet që ne kemi pasur del që si shembull është marrë Tirana, por Tirana përpara se të kalojë në sistemin e pagesave dhe në rrugë, pra në akset kryesore, ndërtoi, janë 6 parkime nëntok dhe mbi tokë në disa pole që ne kemi, duke zgjidhur mundësinë që qytetarët të kishin ku të parkonin. Ne menduam sikur e kishim zgjidhur dhe propozimi im ishte që për momentin ne ta shtrijmë këtë nëpër sheshet ku mendojmë, në parkimet që po ndërtohet të tipit parkimi ke “Stacioni i Trenit”, por nëpër rrugë të mos aplikohet. Në rrugën kryesore dhe në bulevardin kryesor të aplikohet në një moment të dytë kur bashkia t’i ketë dhënë mundësinë qytetarëve të parkojnë në këto parkime ku mund të ndërtohen në një të nesërme. Pse kjo? Nuk është thjesht për motivin ekonomik, i cili natyrisht është një rëndesë të cilën qytetarët do ta kenë, është një problem edhe për bashkinë. Pyetja ime është që si do të menaxohet, duke pasur parasysh që propozimi është që rreth godinave, në sheshet rreth pallateve apo aty ku të jetë mundësia qytetarët të parkojnë pa lekë, këto që janë rezident. Nëqoftëse ato do dalin dhe nuk do të gjejnë parking, pra do të dalin në rrugë kryesore në atë rast duhet të kryejnë një pagesë zona A prej 100 mijë lekë të vjetra në vit, 50 mijë lekë të vjetra në vit zona B. Kjo për mendimin tim do të jetë problematike, sepse nëqoftëse të gjithë do ta pagujnë ne nuk kemi zgjidhur problemin inicial, pra atë që ne duam të zgjidhim, ku dhe mjetet mos të qëndrojnë për një kohë të gjatë nëpër rrugë, duke i dhënë mundësi parkimit të gjithëve, duke i dhënë mundësi e shkëmbimit ku dhe parkimet të jenë të lira herë pas here. Për këtë qëllim pyeta dhe më thanë që policia bashkiake aktualisht janë 80 vetë dhe këto do të jenë subjekte, të cilët do të kontrollojnë dhe monitorojnë të gjithë procesin në të gjithë këto

zona që do bëhet parkimi me pagesë, pra këto 80 persona në periudhën e fluksit ku Durrësi shtohet me dyfish pjesa e popullsisë, ku turistat do të vijnë dhe tendeca është që gjithmonë vijnë me mjete të marra me qera apo që do kërkojnë parkime me pagesë, pra këto 80 persona edhe sikur të jenë vetëm me këtë detyrë, pra monitorimin, kush e ka paguar, kush nuk e ka paguar, a ka kaluar ora apo s'ka kaluar ora dhe nuk i del koha, imagjinoni për problemet që ka Durrësi në periudhën e fluksit.

Problem tjetër në mendimin tim është që, për zgjidhjen e këtij procesi nuk do të ishte as aboneja që do të ishte një tarifë për gjithë zonën, që qytetarët e paguajnë një herë dhe mund ta parkojnë në çdo zonë, pra mos të ishte e ndarë që rezidenti i lagjes 1 nuk parkon dot ke lagjja 6 dhe anasjelltas, sepse nuk zgjidhim dot atë çfarë kemi qëllim kryesor, parkimin në qytet . Dhe për këtë motiv propozimi që ngrita në komision dhe në dëgjesën publike është që për momentin të bëjmë sheshet dhe parkimet publike që do të bëhen në tokë dhe nëntokë, ndërsa për rrugët mendojmë një periudhë afatshkurtër, por jo për momentin. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Më fal një sekond Flutura.

Doja të ndërhyja për ju z.Muka, si anëtar këshilli dhe jo si kryetar, duke qenë se jemi banorë të të njëjtës lagje dhe ne të dy e vuajmë pjesën e parkimit tek zona e parkimit tonë kur ne vijmë nga puna dhe nuk gjejmë dot vende parkimi, besoj e ke të qartë këtë pjesë, sepse shumë makina që udhëtojnë jashtë vendit apo vijnë për aktivitete të ndryshme pranë stacionit trenit, duke qenë me pagesë nuk i jepet mundësia parkimit të atyre mjeteve që mund të tregtohet apo shiten apo të parkojnë për një afat të gjatë kohor 1-2 javor, për shkak se udhëtojnë jashtë.

Ky mendoj është qëllimi dhe parkimi publik që ju e thoni me të vërtetë është një zgjidhje e drejtë, ama kjo situatë që ndodhi mund të ndodhi sërish, pasi ato nuk i drejtohen parkimit publik pasi ato nuk kanë pagese. Kaq kisha e thashë këtë koment meqë jemi banor të një komuniteti.

Dritan Burgija : Mund të bëj nja 2 komente?

Ardian Muka: Thashë nuk mendoj që e zgjidh pasi fakti që çdo familje i lind e drejta që të paktën një targë, një mjet ta ketë të regjistruar kundrejt pagesës sipas zonës 10 mijë lekë të reja apo 5 mijë lekë të reja në vit, kjo do të bëjë që prap ato vende do të jenë të zëna.

Emiriana Sako : Ajo është dinamike.

Ardian Muka: Në moment që e ka paguar dhe e lenë poshtë shtëpisë për një muaj apo dy muaj ç'rëndësi ka, sepse ai e ka paguar. Bashkia do të realizojë një të ardhur dhe këtu do të insistoja që të jemi transparent ke pjesa e administrimit të këtyre fondeve për aq sa do të arrij....

Ani Dyrmishi : Ajo është pjesë tjetër pastaj.

Ardian Muka: Duhet të kemi një qëllim ato çfarë do të dalin nga parkimi të investohen në parkime të reja.

Dritan Burgija: Ta vazhdoj dhe unë me një koment ju lutem?

Ardian Muka: Po.

Dritan Burgija: Ajo është e vërtetë që thoni ju, që të zgjidhim problemin e makinave që janë të parkuara me muaj në vende të caktuara, me numra telefoni shitet apo jepet me qera, kjo do ta zgjidhi këtë problem.

E filloni relacionin duke thënë që kjo është një nga prioritetet kryesore që Bashkia Durrës ka në përputhje me nevojat dhe dëshirat e qytetarëve. Nuk besoj që ndonjë qytetar, qoftë në këtu brenda s'kemi ndonjë qef të madh me shku me paguar aty ku parkojmë. Ka modele në botë që është me orar, por është pa pagesë, t'i vendos orarin në xham të makinës dhe nëse e ke tejkaluar orarin vjen polici bashkiak dhe të ndëshkon për këtë pjesë. Nuk kemi pse i rëndojmë qytetarët në këtë pike. Pastaj thoni për shkak të sistemit infrastrukturor, për këtë me thënë të drejtën unë ju falenderoj pa masë sepse kemi 24 vjet që ju themi që nuk kemi bërë asgjë për këtë qytet, në vend që të zgjeroheshin rrugë janë ngushtuar rrugë, në vend që të mendohesh për parkim edhe ato vende parkimi që ishin përgjatë bulevardit ju vendosën ato hekurat përpara bizneseve që është një detaj që të gjithë bizneset e vuajnë edhe sot e kësaj dite.

Synoni alternativat e transportit, është e dukshme domethënë që synoni modelin e Erion Velis atij kryehajduti të Tiranës, por nuk është ai për tu marrë model, dhe zoti Muka tha që bëri 5-6 parkime, por 5-6 parkimet e tij domethënë kanë shërbyer vetëm për të fryrë xhepat e tij dhe unë uroj që ne si durrsak mos t'i shkojmë modelit të tij. Makinat janë mjet pune sot, nuk janë mjet lluksi, nuk janë mjet qejfi, ju kërkoni transportin mondal. Si mund të zgjidhin njerëzit hallet dhe punët? Do kthehem para 90-s? Ky është qëllimi? Që të lëvizim të gjithë në këmbë apo me biçikletë.

Pastaj sa i përket pikës ku thoni që banorët do parkojnë me atë kartën, që do të marin nga komuna do të parkojnë pa lekë dhe pastaj i detyroni që të paguajnë 100 mijë lekë për rrugët, ka zona që nuk ka mundësi brenda pallateve të parkojnë. Pse duhet ta rëndojmë në këtë banorin mund të jetë ajo karta e rezidentit mund të jetë pa pagesë. Pse duhet të jetë me pagesë?

(..... shumë zhurmë, flasin gjithë përnjëhërë...)

Komentet mund t'i bëni mbrapa ta mbaroj, se e dini të gjithë, se unë nuk flas shumë gjatë.

Kështu unë propozoj që, kjo është një pikë që mund të flasësh pafund do të ju them dhe këtë tjetrën që për shumë pak muaj jemi në fushatë elektorale, në çdo vend të botës këto gjëra bëhen pasi mbarojnë zgjedhjet. Juve me arrogancë përpara zgjedhjeve shkoni dhe i futeni në xhep qytetarëve.

Emiriana Sako : Nuk është periudhë zgjedhjesh.

Llesh Çuni : Fitoni zgjedhjet Ju, ç'a halli ke ?

Dritan Burgija: Ta mbaroj llogjikën time. Kur them me arrogancë i futeni në xhep qytetarëve, sepse mendoni që keni formulën e fitores së zgjedhjeve, por ta dini që do të jetë një kacafytje e papame kësaj radhe nuk do të ju lejojmë që të bëni atë që keni bërë në çdo zgjedhje. Shkuam në 2 palë zgjedhje në kushte jo të barabarta.

Llesh Çuni : Vetëm kacafytje doni ju. Po se merrni dot as me kacafytje se populli nuk ju do.

Ani Dyrmishi: Llesh, të lutem.

Llesh Çuni : Thua hajdut Erion Veliaj, e voton gjithë Tirana.

Ani Dyrmishi: Ju lutem mos dilni nga rendi i ditës.

Dritan Burgija: Unë flas në emër të grupit, më lëni ta mbaroj.

Ani Dyrmishi: Në emër të grupit t'i mund flasësh për pikat e rendit të ditës.

Dritan Burgija: Ju faleminderit shumë për vëmëndjen. Punë të mbarë.

Qytetarët do ta shofin qëndrimin tonë dhe qëndrimin tuaj!

Ani Dyrmishi: z. Xhelili, të lutem.

Rolant Xhelilaj: Jam dakort me zotin Burgija vetëm për idenë që foli në emër të grupit nga qëndrimi i tij pak të kundërt me komshiun, me zotin Muka.

Ani Dyrmishi: Komshi e kam unë, jo ai.

Rolant Xhelilaj: Komshi në këshill.

Në total jam dakort me një pikë, që të gjitha diskutimet pamvarësisht atij ngjyrimit politik me duar dhe me këmbë sikur jemi në fushatë , je i çik shpejtë Tani, dhe nuk të hyn në punë personalisht ty.

Jemi të gjithë dakort që është një problem që ka nevojë për një zgjidhje. Dhe bashkia ka menduar këtë zgjidhje, e cila rregullon për aq sa mundet të rregullojë, në atë situatë që ka trafiku dhe parkimi i mjeteve kudo jo vetëm në Shqipëri, por kudo edhe nëpër botë, si rezidentin, si qytetarin si edhe atë qytetarin tjetër që përdor mjetin tamam me të drejtë për punë, domethënë kërkohet që të merret një masë për të ndikuar pozitivisht në stabilizimin e lëvizjes së mjeteve në qytetin e Durrësit. Masë që për mendimin tim pa dashur të kundërshtoj zotin Myshketa është pjesës dërrmuese e qytetarëve, pastaj propozimet me çmim të ulët, me çmim të lartë janë ndjesi personale edhe të anëtarëve të komisionit, që realisht kanë opinionin e tyre që diçka ndikon në xhepin e qytetarëve, patjetër që çdo masë që ne marrim për përmirësimin e situatës shoqërohet me disa ndërhyrje që kanë edhe shpenzime, kanë edhe ndryshim metode veprimi. Ne jemi dakort që deri më sot parkimi ka qenë pa lekë. Çfarë ka ndodhur? Rrëmuje e tërë. Absolutisht të gjithë kemi pakënaqësi për njëri tjetrin për pushtetin vendor edhe pushtetin qëndror të të gjithë viteve.

Çfarë po kërkojmë sot? Të vendosim disa rregulla loje, të cilat të përfshijnë disa fusha, edhe zonat mes pallateve për rezidentët, edhe ato me pallat po që nuk kanë zonë brenda siç tha zoti Burgija, por diçka do t'i përcaktohet si rezident dhe kjo të shoqërohet dhe me tarifat përkatëse për lënie

në rrugët kryesore që pak kanë lidhje me pozicionin e punës. Në përgjithësi kushdo që lë makinën po marr rrugën 'Taulantia', të paktën që jam banor i saj dhe ka një pjesë tjetër të anëtarëve të këshillit që banojnë atje, ku makinat vijnë për të shkuar për të pirë kafe, për të bërë një lëvizje bregut të detit, për të ngrënë një drekë, për të ngrënë një darkë dhe krijohet një ngarkesë shumë e madhe për vetë ata që nuk gjejnë vend ku të lenë makinën, por edhe për ne që jemi banorë të zonës përkatëse. Pra ka një lloj përplasje të dëshirave dhe opinionëve midis gjithë grupeve.

Çfarë bëjmë në këtë rast? Vendosim disa rregulla loje, vendosim disa rrugë kryesore, ndërtojmë dhe ato kuartallet, ku rezidentët do të lenë makinat, vendosim edhe rezidentin me kartën e dytë ku do të paguajë 100 mijë lekë në vit, që është një shifër minimale për të lenë makinën, pastaj edhe në rrugë të tjera të qytetit. Dhe e gjitha kjo them se do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e qarkullimit të mjeteve dhe të lëvizjes së njerëzve në këmbë, ndërkohë është një ngarkesë goxha e madhe për bashkinë e Durrësit për implementimin e saj. Në këtë pikë edhe zoti Muka edhe zoti Burgija, bëjnë mirë që i tërheqin vëmendje bashkisë, që është një pikë e fortë, që kërkon punë që kërkon vëmendje. Koha do të tregojë sa do të jemi në gjëndje që kjo masë e marrë nga ne të ndikojë deri diku pozitivisht. Që nuk është zgjidhja e problemit këtë e dimë. Jemi të gjithë këtu banorë të Durrësit dhe të kërkosh sot e të thuash, duam parkime ai atje në Tiranë bëri 6, ne e dimë edhe llojin e qytetit që kemi, edhe Durrësin qytet arkeologjik dhe me të gjitha peripecitë që ka. Të gjitha përpjekjet do të bëhen të stabilizojmë hap pas hapi një problem, që është i të gjithë qytetarëve. Dhe unë në emër të grupit duke mirëkuptuar edhe anëtarët e grupit tonë, që patën opinione për ndryshime tarife ta miratojmë këtë projektvendim siç e ka sjellë aparati i bashkisë. Ju faleminderit.

Ani Dyrmishi : Po, z. Myshketa.

Jonuz Myshketa : Në lidhje me relacionin që është paraqitur nga bashkia në dëgjesën e saj në lidhje me mënyrat alternative të transportit opinioni im ka qenë gjatë dëgjesës që është e pamjaftueshme, që përpara se të shkohet me tarifimin e rrugëve me pagesë dhe deri këtu do ta zgjidhim, por nuk kemi as një relacion narrativ se sa e zgjidh me %, sa e monitoron ose e bën të përshtatshëm pjesën e transportit publik, këtu duhet të zgjidhim disa çështje paraprake siç është edhe transporti publik. Duke qenë se në çfarë kemi kërkuar gjykojmë se transporti publik është ai që është një zgjidhje e përdorimit ose mospërdorimit të mjeteve nga qytetarët, si transporti publik, transporti urban dhe ndërurban.

Kemi zonën A, ku janë edhe pjesa më e madhe e bizneseve, sidomos edhe bizneset e sezonit turistik, restorantet dhe lokalet, e cila ka dhe pjesën më të madhe të punonjësve. Shumë punonjës janë të detyruar të marrin automjetet e tyre ç'ka e bën të rënduar dhe transportin dhe trafikun gjithashtu dhe nevojën për parkim. Këto zgjidhen nëpërmjet një rrjetit të mirëmenduar të transportit publik urban duke shtuar oraret sidomos gjatë sezonit turistik, pra të zgjasin përtej orarit përcaktuar, do të krijonte mundësinë e mos marrjes së mjeteve që do të ishte një kosto më pak për punonjësit qoftë dhe për bizneset do të kishin këtë lloj akses gjë e cila zgjidhet me shtimin e mjeteve të transportit publik. Kjo do të ndihmonte dhe në lëvizshmërinë e turistëve po të kishin një transport urban më eficient. Kjo do rriste dhe interesin e turistëve që përtej qëndrimit në hotele

kanë kuriozitetin të lëvizin në qytet duke shijuar dhe transaksionet që ofrojnë shërbime në qytetin e Durrësit dhe do të jetë një ndihmë ekonomike për gjithë pjesën e biznesit.

Flasim për hapsirat ndërmjet pallateve, të cilat janë të pamjaftueshme për banorët, unë mendoj që kjo nuk e zgjidh problemin e tyre të paktën rezidentëve, por e shton këtë problem sepse dyndja e njerëzve të cilët do të shkojnë të gjejnë parkim pa pagesë do të ishte akoma më e madhe. Kemi shumë objekte shumëkatëshe të pallateve, të cilat nuk i kanë në përdorim parkimet e tyre, pra banorët që kanë blerë shtëpitë ndoshta dhe parkimet nuk parkojnë në këto vendparkime që janë nën pallat ndoshta edhe të pamjaftueshme, por sikur të ishin aksesibël do e lehtësonin diçka më tepër. Nga ana e bashkisë duhet të kishim një rezymë të qartë se sa objekte të cilat kanë të ndërtuara parkime nëntokësore nuk janë të vëna në punë, por me vendosjen e tyre do të ndihmonte. Vendparkime për rezidentët e cila është 10 mijë lekë e cila bie ndesh dhe me tarifën që ne kemi aprovuar dhe për vendparkimet që duan bizneset dhe mund të jetë kërkesë shumë e madhe dhe e bën të pazgjidhshme ose del jashtë lojës parkimi me pagesë në rrugën kryesore.

Kam edhe një kërkesë tjetër aktualisht bizneset që kanë një taks për parkimin kur t'i bëjmë parkimet në rrugë kjo taksë do t'i hiqet bizneseve apo do t'i qëndrojë?

Baret dhe restorantet paguajnë parkime për klientët nuk paguajnë për punonjësit e tyre. Pra çfarë do të bëhet me to? Pasi do të ketë një pagesë për parkimet në rrugë kryesore, por do të kenë dhe një taks për parkimin me biznese të ndryshëm, të cilët për mua është një rëndesë e dyfishtë në lidhje me çfarë arrijmë t'i ofrojmë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Kola.

Flutura Kasa: Para 2 mbledhjesh të Këshillit Bashkiak kamë ngritur shqetësimin për makinat që kanë shkrimin shiten dhe as nga opozita dhe as nga mazhoranca asnjë nuk ma mbështeti diskutimin.

Kam pasur dhe një diskutim të fortë dhe me drejtorin e policisë bashkiake dhe pikërisht diskutimi kryesor ishte mungesa e kësaj që po diskutohet tani. Kështu që vonesa, jemi vonë, por ta shtyjmë nuk qëndron dhe unë dal kundër vetes time, që e kam ngritur disa herë dhe nuk e di se sa herë i kam shkuar dhe kryetares në zyrë për këtë shqetësim. Kështu që boll mo, se janë bërë kangrenë ato makinat shiten ose ato rrangallet që kanë ngelur nëpër Durrës, kështu që unë jam dakort ta kalojmë në votim, flas në emër të grupit të PSD-së.

Ani Dyrmishi: Ja japim fjalën kryetares.

Ermiriana Sako: Faleminderit!

Fakti që ka qark shumë diskutim dhe debat do të thotë që është një problem real në qytet dhe ne e kemi sjellë si propozim në Këshill si një instrument për të gjetur zgjidhje për problematikën e përdorimit të rrugëve, uljes së trafikut. Kjo nuk është një masë e vetme kemi pasur një vizion se si do të punojmë në këtë program apo në këtë funksion që ka bashkia e Durrësit dhe pikërisht kemi nisur me ndërtimin e parkimit në hyrje të qytetit, i cili do të akomodojë rreth 400 vende parkimi, procesi i punës atje ka shkuar mirë dhe besoj se brenda vitit mund të përfundojë si objekt.

Më tej kjo është një fazë e dytë, pra ku parashikojmë disa akse dhe kemi zgjedhur pikërisht disa akse për të gjitha problematikat që u ngritën edhe nga këshilltarët e djathtë do të thotë që a ka mundësi policia bashkiake të mbulojë të gjitha rrugët, pra pikërisht për këtë arsye nuk kemi vendosur shumë rrugë në qytet, por kemi vendosur ato akse, të cilat kanë një lëvizshmëri dhe një fluks sidomos gjatë sezonit turistik. Dhe hapi i tretë, i cili do të ndihmonte shumë morfologjinë urbane të qytetit, por edhe lëvizshmërinë e automjeteve dhe të qytetarëve është investimi për unazat e qytetit për të cilin ne kemi kërkuar, i kemi bërë kërkesë Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe kemi kërkuar sigurisht me bashkitë e tjera për të përfutur këtë financim, presim me miratimin e aktit normativ, i cili bëhet në fund të këtij muaji apo në fillim të korrikut të marim dhe një përgjigje për fillimin e procedurave për këtë projekt. Këto janë elementët, që të tre të parë së larti, do të bëjnë të mundur zgjidhjen e problemit të trafikut dhe parkimit në qytetin e Durrësit.

Në material është e qartë që ne kemi vendosur akset kryesore, kemi lënë mundësinë e marrjes së një leje për njërin nga mjetet për banorët që jetojnë në këto rrugë, pra që dalin pikërisht në pallatet që jetojnë në akset kryesore si një alternativë ku të ketë mundësi dhe të parkojnë mjetet e tyre, pra për të mos i lënë pa alternativë fare ato familje që jetojnë në lagjen nr.1 apo në lagjen nr.3 të cilat pallatet janë pa parkim nëntokësore apo kanë 2 apo 3 mjete në familje.

Sigurisht që ne kemi një kulturë të përdorimit të mjeteve edhe për distanca shumë të shkurtra, por nëpërmjet këtij instrumenti le ta dekurajojmë sadopak këtë kulturë sepse shofim që trafiku në qytete të tjera është më i dendur gjatë javës, kurse në Durrës përgjatë 6-8 muaj, është më i dendur gjatë fundjavës dhe për këtë arsye kemi shtuar edhe dy ditët e shtunë dhe e djelë vetëm për sezonin turistik.

Parkimet e blloqeve, pra ato të cilat kanë qenë të miratuara pa pagesë në këshill do të bëhen me pagesë që do të thotë parkimi pas dy kullave parkimi pas Blustarit, parkimi tek Muzeu i Dëshmorëve dhe atje ku kemi rrugë të cilat janë me një sens pra hyn dhe del nga i njëjti vend do të vendosim sisteme automatike për dhënien e biletës dhe për pagesën në mënyrë që të ulim sa më shumë mbulimin me burime njerëzore.

Mendojmë që do të ketë një efekt pozitiv kjo, për arsye se dekurajimi i përdorimit të mjeteve do të çojë në aksesin më të mirë të këmbësorëve dhe lëvizjen më të lartë për këmbësorët. Do të ketë një efekt financiar në rritje për bashkinë e Durrësit që patjetër ne duam ta çojmë për investime për ato që do të diskutojmë së bashku këtu në këshill dhe pse jo për të përforcuar pozitat e Policisë Bashkiake. Pra, me fillimin e kësaj praktike mundet që duke monitoruar dhe parë deri në 6 mujorin tjetër do të jetë e sukseshme apo jo dhe çfarë efekti do të ketë, bëjmë edhe rritjen e kapaciteteve të Policisë Bashkiake që vitin tjetër të shërbejmë akoma më mirë në territorin e qytetit tonë.

Unë e kuptoj edhe kohën që gjithsecili prej nesh merr nëpërmjet komunikimit me mediat, por faktin e dëgjësës së pamjaftueshme e quaj hipokrizi, sepse në këtë rast neve veprojmë sipas legjislacionit pra njoftojmë në faqen e bashkisë për dëgjuesin publike, të gjithë ato që janë të interesuar bëhen pjesë. Ju si këshilltarë keni të drejtë të thërrisni dëgjesa publike vetë, dhe nga ana tjetër ju rikujtoj që në momentin e miratimit të buxhetit për të gjitha dëgjuesat që janë bërë nga bashkia gati për një muaj asnjë nga ju nuk ka qenë prezent për të ngritur zërin për shetësimet e qytetarëve. Unë do të ju ftoj që të vini në dëgjuesat e radhës, të cilat do të vijnë në tetor, por do të kemi kohë për të paraqitur fakte do të jeni apo jo, për të shprehur këtu shqetësimin e përfaqësimit

të qytetarëve. E thashë që në fillim që kjo vjen si një nevojë emergjente e qytetit për trafikun, i cili rëndohet më së shumti gjatë sezonit veror.

Meqenëse po flasim për këtë temë kemi marrë dhe një vendim tjetër shkurtimisht. Për mbylljen e rrugës tregtare dhe kthimin e saj në pedonale, do të bëhet lëvizja në një sens nga rrugët, pra rruga e prefekturës me Karl Topinë dhe rruga e Stanit të cilët gjatë kësaj jave Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit do ta pajisin me sinjalistikë përkatëse në mënyrë që gjatë orarit 7 me 23, pra 7 me 11, kjo hapësirë të përdoret si hapësirë publike dhe pedonale. Ka qenë një vendim i marë që vitin që shkoi i mirëpritur nga qytetarët, por edhe nga bizneset ne kemi menduar që ta shtrijmë në muajin korrik për këtë vit. Ju falenderoj.

Ani Dyrmishi: Faleminderit kryetare.

Përsa i përket pikës 12 besoj s'ka më koment. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 12 të rendit të ditës?

Sekretaria të numëroj votat.

24 pro

Kundra?..... 12 kundra

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 24 vota pro dhe 12 kundra miratohet pika 12.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 13**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave z.Xhelilaj

Rolant Xhelilaj: Duke kërkuar ndjesë për pikën 9 për zotin Myshketa. Për pikën 13 opozita ka abstenu, e kalojmë në votë projektvendimin përkatës.

Ani Dyrmishi: Komentë për pikën 13 ka?

Po z. Burgija.

Dritan Burgija : Ne kemi qënë që kemi ngritur zërin për ato pallatet aty te rruga “Abaz Çelkupa” dhe një shpjegim do doja në lidhje me fondin, vë re se është dyfishi i fondit të parashikuar më parë. Desha një shpjegim.

Ani Dyrmishi: Atëherë z. Lorenc Façja.

Lorenc Façja (*Drejtor i Drejtorisë së Projekteve Dhe Infrastrukturës Publike pranë bashkisë*): Përshëndetje!

Në lidhje me dy propozimet që kemi prurë për dy pallatet në “Abaz Çelkupa” dhe pallatin “Arvi” si rezultat i ankesës së banorëve ne i kemi drejtuar studios projektuese, e cila ka bërë një rishikim të projektit, duke qënë se ka gati 4 vite nga hartimi i projektit deri më sot dhe ka pas nevojë për disa ndryshime në projekt, të cilat i kemi vërejtur ne si përfaqësues të bashkisë se bashku me zyrën e projektimit dhe kemi bërë vetëm ndryshim të preventivit. Këtë gjë....

Dritan Burgija : Pra, është bërë një ndërhyrje më e thelluar?

Lorenc Façja: Ka pas nevojë për disa ndërhyrje, po. Dhe për këtë gjë e kemi dërguar në Institutin e Ndërtimit, presim oponencën dhe së shpejti do ta hedhim për procedurën e tenderimit.

Dritan Burgija: Okej (okay)

Ani Dyrmishi: Faleminderit!

Komente? Nuk ka.

Atëhere kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 13 të rendit të ditës?

Kundra?...1

Abstenim?...4

Ngreni dhe njëherë dorën Pro.

27 pro,

Atëhere, me 27 vota pro, 4 abstenim, 1 kundra , 4 pa votuar miratohet.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 14**, I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit znj Shemsi.

Edlira Shemsi : Komisioni i Barazisë Gjinore Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit pasi shqyrtoi listën për individët që do marrin ndihmë ekonomike për muajin Qershor me fondin 6 % dhe me fondin e të ardhurave të bashkisë, e miratoi atë dhe ja paraqet Këshillit për miratim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit znj.Shemsi.

Komente përsa i përket pikës 14 ka?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 14?

Kundra ?....

Abstenim?... Nuk ka

Atëhere, me 36 vota pro, miratohet pika 14.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 15**, i japim fjalën Komisionit të Politikave të Zhvillimit të Turizmit z.Alketa Ngjeçi

Alketa Ngjeçi : Pasi dikutuam për pikën 15, vendosëm ta kalojmë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit znj.Ngjeçi.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës z. Muka.

Ardian Muka: Pasi e shqyrtuam vendosëm të kalojmë sot në seancë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Koment përsa i përket pikës 15, ka?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Ardian Muka: Kisha unë.

Ani Dyrmishi: Po, më fal.

Ardian Muka: Meqenëse ne këtë e kemi kaluar dy mbledhje para kësaj, pse nuk ishte pjesë e saj? Kërkesa ka ardhur mbrapa ?

Emiriana Sako : Ka ardhur mbrapa.

Ani Dyrmishi: Për shkak të kërkesës së subjektit që ka ardhur mbrapa.

Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro?

Kundra?...Nuk ka

Abstenim?... Nuk ka

Atëhere, me 36 vota pro, miratohet.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 16**, pikën e fundit të rendit të ditës i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonja Devolli.

Edlira Devolli: Faleminderit.

Komisioni u mbledh shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Koment përsa i përket pikës 16, ka?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 16 të rendit të ditës?

Kundra?...Nuk ka

Abstenim?... Nuk ka

Atëhere, me 36 vota pro, miratohet pika 16.

- Ka kërkuar fjalën **për diskutim** vetëm z.Jonuz Myshketa.
Z. Myshketa !

Jonuz Myshketa : Atëherë pas bisedimeve që kemi pas me grupin e studentëve kanë dal njësr kërkesa dhe një alternativë në lidhje me transportin publik. Kërkesa e tyre ishte që të ndryshonin oraret, fashat në oraret më vulnerabel, kur të fillojnë e mbarojnë leksionet, rregullimi në një gjendje të përshtatshme të stacioneve.

Dhe në lidhje me kartën e studentit, do jetë një ndihme e madhe për ata dhe nuk kanë asnjë lloj lehtësie. Kjo vjen drejtë për drejtë si një ankesë e tyre, që gjykojnë që të jenë një bonus, ashtu siç i përket studentëve, duke filluar qoftë në njësi financiare si supermarketet , bibliotekat, gjithashtu dhe për transportin publik. Abonetë gjithashtu janë një pjesë e theksuar e shërbimit të munguar si për studentët ashtu dhe për banorët. Abonetë të pamjaftueshme dhe po ta vini re një radhë e frikshme për marrjen e tyre gjatë kohës që ato dalin.

Përsa i përket dezinfektimit të qytetit kam parë që realisht është bërë dezinfektimi, por janë disa zona në lagjjen 5, lagjjen 6, qoftë dhe në lagjjen 1 ku ka ankesa nga banorët në lidhje me insektet.

Këto ishin pyetjet e mia.

Do bëja dhe një reagim për problemet që ngrita mbledhjes së kaluar, kanë kaluar për hir të së vërtetës, pra bashkia ka reaguar për kabllat e telat, por është e pjesshme. Është vetëm tek pjesa e

Poliambulancës. Shpresoj mos të jetë bërë vetëm për prerje shiriti, por për gjithë zonën, pasi është një pjesë e shëmtuar qoftë për pamje e qoftë për mirëmbajtjen pastaj.

Dhe ka një ndërhyrje të pjesshme të hotel Vollgës, për këtë faleminderit, por është e pamjaftueshme. Kur presioni rritet kemi bashkëpunim më të mirë për ofrimin sa më të mirë të shërbimeve të qytetit, që meriton shumë më tepër.

Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit z. Myshketa.

Znj. Kryetare !

Emiriana Sako: Po.

Atëhere po e nis nga studentët, ne ende nuk e kemi përfunduar procedurën e prokurimit për realizimin e kartës, pra sot studentët në Durrës nuk marrin shërbime në bazë të kartës së studentit. Është futur që vjet në buxhet, por për çështje teknike të procedurës nuk u realizua, na është dashur që ta riprokurojmë nga e para. Ndërkohë i kemi bërë thirrje të gjithë subjekteve, të cilët kanë biznese supermarketi këtu në qytetin e Durrësit, në përgjithësi kemi pasur një përgjigje pozitive për të gjithë ata për të ulur pagesat e shportës ose ushqimet bazike. Dhe sigurisht që do të jetë pjesë e kartës së studentit. Do të jetë akses i lirë, falas pra në të gjitha institucionet publike, aktivitete të tjera.

Pjesa e lëvizshmërisë urbane e transportit urban është një shqetësim, është një problem kompleks le të themi. Ne kemi pasur tashmë prej dy vitesh kërkesa nga operatorët, të cilët kanë kontrata të gjata në bashkinë e Durrësit për të bërë rimbursim në sektorë, në funksione të caktuara të bizneseve të tyre për arsye të rritjes së konsumit, të rritjes së vlerës së naftës dhe kemi ngritur një grup pune së bashku me ministrinë kemi kërkuar mbështetje e saj, sepse ligji ka nevojë për daljen e VKM-ve të cilat detajojnë se si njësitë qeverisjes vendore do duhet të bëjnë mbështetjen apo rimbursimin e pjesshëm për këtë sektor. Dhe me daljen e kësaj VKM-je do të marrim masat që patjetër me miratimin dhe duke dëgjuar njëri tjetrin këtu në këshillin bashkiak për të gjetur zgjidhje sa më të mira, në mënyrë që në thelb të kërkojmë pastaj rritjen e standartit të lëvizshmërisë edhe të mjeteve edhe të pjesës së realizimit të stacioneve të autobuzëve.

Pjesa tjetër e dezinfektimit është një proces pune, detyrë funksionale e jona që e kemi bërë pas përfundimit të periudhës së reshjeve, është bërë në zonën e plazhit dhe në zonën e Durrësit, është proces që bëhet gjatë natës, në shëtitore dhe në zona të tjera të qytetit, por është e pamjaftueshme, sepse në qytete të mëdha është më efektive nëqoftëse ky dezinfektim bëhet nga ajri. Normalisht këtu ka dhe një mbivendoje të kompetencave me Ministrinë e Shëndetësisë, e cila nga ana tjetër ka bërë punën e saj, por është fokusuar kryesisht në kanalet vaditëse kulluese atje ku janë edhe vatrat kryesore të insekteve. E kemi kërkuar këtë si mbështetje nga ana e tyre, por pjesën tonë ne e kemi realizuar me ndërmarrjet e varësisë që kemi në bashki.

Pjesa e telave pastaj është një proces pune i përditshëm, por mbase nuk ke si ta shohësh çdo ditë apo thjesht duke e reflektu atë në rrjetet sociale, është e pamundur që të kuptohet çdo gjë që ndodh. Kemi ndërhyrë ke disa rrugë në qytet, por është një punë dinamike që kërkon hapjen e rrugëve, vendosjen e infrastrukturës. Do një bashkëpunim shumë të madh me operatorët e shpërndarjes së internetit, sepse ato janë të cilët vendosin infrastrukturën e tyre në rrjetet

nëntokësore. Nuk flasim për rrugët, të cilat bëhen nga e para, sepse ato i kanë këto, pra janë pjesë e projektit këto investime, por në lagjet të cilat janë të konsoliduara dhe situata urbane është ekzistuese duhet që të hapen enkas rrugët me bashkëpunim me kompaninë private për të bërë pastaj mbylljen. Dhe hap pas hapi jemi duke punuar, kemi përfunduar një pjesë të punës në lagjen 18, ku ka përfunduar edhe investimi i qeverisë shqiptare për veshjen me kapotë të objekteve, në lagjen 16 jemi duke punuar, dhe në rrugët e qytetit atje ku mundet të shpërndahen grupet e punës, le të themi, sepse e kemi një punë të përditshme.

Ani Dyrmishi: Faleminderit kryetare, faleminderit të gjithëve.

Do ju bëja një kërkesë përpara se ta mbyllnim, ju lutem në mbledhjet e komisionit si anëtarëve të pozitës, si ato të opozitës, apo të partive të ndryshme, ju lutem të bëheni pjesë, sepse është për të mirën e vendimeve që ne marrim për të ecur përpara.

Ju faleminderit. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 25 (njëzet e pesë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

DENISA LUARASI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Partisë DIU:

FLORIAN TAHIRI